

1. Shpenzime Personeli

Fondi i akorduar për periudhën Janar - Prill 2017, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli është 26.028 mijë lekë, ndërsa realizimi është 22.346 mijë lekë ose 86%, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë në plan 4.392 mijë lekë, ndërsa realizimi është 3.093 mijë lekë ose në masën 70%. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) si 4/mujor janë realizuar në masën 84%.

Gjatë periudhës Janar – Prill 2017, institucioni nuk kanë përdorur të plotë fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, për shkak të mosplotësimit të strukturave organike.

Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2017, nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë kësaj periudhe.

Ka patur mungesa në 3/mujorin e parë:

- 1- Komisioner të MKPT^{së},
- 1- Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve,
- 1- Këshilltar,
- 1- Ndhmëskomisioner të MPKT^{së},
- 1- Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit dhe Koordinimit të Projekteve

2. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar për shpenzime mallra e shërbime (**zëri 602**) për periudhën Janar – Prill 2017 është 5.940 mijë lekë, ndërsa realizimi është 3.246 mijë lekë ose 55% e buxhetit.

Për vitin 2017 shpenzimet operative, janë përdorur për pagesat e blerjeve për kancelari, materiale pastrimi, furnizime me materiale të tjera zyre, njoftime publikime në gazeta dhe botime, shpenzime për energjisë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafonë, shërbimi postar, siguracion automjetesh, dieta brenda dhe jashtë vendit, shpenzime pritje-përcjellje të huajve.

Fondi për transfertat korentë të huaja (**zëri 605**) për vitin 2017, është 1.500.000 lekë, ndërsa realizimi është 1.376.125 lekë ose 92% i buxhetit të planifikuar.

3. Shpenzime në investime

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit është 4,000 mijë lekë, ndërsa realizimi 0.

në mijë/lekë

Projekti	Kodi i Projektit	Plan	Fakt	%
Blerje Pajisje	M660001	500	0	0
Pajisje - Kompjuterike	M660009	500	0	0
Fondi i ngrirë (Blerje automjeti)	M660003	3.000	0	0

“Blerje Pajisje”

Për këtë zë të investimeve jemi në procedure prokurimi.

"Pajisje kompjuterike"

Për këtë zë të investimeve jemi në procedura prokurimi.

"Fondi i ngrirë (Blerje automjeti)"

Për këtë zë të investimit institucioni do të përgatit një informacion të detajuar dhe mirë argumentuar në lidhje me nevojën që ka institucioni, për nisjen e procedurave përkatëse për blerjen e një automjeti.

Bashkëlidhur këtij materiali janë evidencat e raportimit për monitorimin sipas Aneksit 1, 2 të shpenzimeve që ka kryer institucioni i Avokatit të Popullit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,